547
14.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK

MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026 NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA, MIRATUAR ME VKB NR.122 DATË.23.12.2025

Të nderuar Këshilltarë!

Ministria e Financave me shkresën e saj nr.18059/15, datë 24.12.2025, në zbatim të Aktit Normativ nr.11, date 19.12.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", ligji nr 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026" të ndryshuar, ka alokuar për Bashkinë Lushnje fonde shtesës në formën e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe pasi të jenë shlyer detyrimet të përdoret për shpenzime të tjera.
Bashkisë Lushnjë i është alokuar vlera totale **24,014,201** (njëzet e katër milionë e katërmbëdhjetë mijë e dyqind e një) lekë si transfertë e pakushtëzuar të përgjithshme, e cila është transferuar në Degën e Thesarit Lushnjë, me qëllim shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Pas shlyerjes së këtyre detyrimeve, fondet e mbetura mund të përdoren për shpenzime të tjera, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Duke qenë se mbledhja e Këshillit Bashkiak u zhvillua në datë 23.12.2025 përpara ardhjes së shkresës nga Ministria e Financave me nr 18059/15 prot datë 24.12.2025 e ardhur në institucionit tonë me nr 11508 prot datë 30.12.2025, për pasojë nuk ishte e mundur të bëhej një mbledhje shtesë e Këshillit Bashkiak për të shpërndarë fondet brenda vitit 2025, fondet në fjalë trashëgohen dhe programohen për buxhetin e vitit 2026.
Gjatë mbledhjes së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) u diskutua mbi destinacionin e përdorimit të kësaj transferte, në përputhje me përcaktimet e Ministrisë së Financave, dhe u vendos që fondi të përdoret për financimin e procedurave të Ndërmarrjes së Pasurisë Publike, të cilat ishin të parashikuara në buxhetin e vitit 2025, por nuk arritën të realizoheshin brenda këtij viti. (vit zgjedhor).
Disa nga keto procedura u riparashikuan në buxhetin e vitit 2026 dhe disa të tjera u menduan të parashikohen me fondet e trashëguara nga viti 2025 (sipas degjesave publike për buxhetin e vitit 2025 dhe 2026)
Shuma totale shkon për Ndërmarjen e Pasurise Publike në vleren 24,014,201 lekë, në programin AB129- Shërbimet Publike Komunitare
Bazuar në llogaritjet përkatëse, propozohet shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar celur në vitin 2025 dhe trashëguar për buxhetin e vitit 2026 sipas tabelës bashkëlidhur, si më

poshtë:

Institucioni	Programi	Gr	Kap.	Produkti	Pershkrimi I produktit	Vlera	Artikulli 602
2129010	AB129	00	01	V452AAB	Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur	22,361,731	22,361,731
2129010	AB129	00	01	V424AAB	Mirëmbajtja rutinë e kanaleve ujitëse dhe kanale kulluese	1,332,470	1,332,470
2129010	AB129	00	01	V426AAA	Shërbimi i Stafit të menaxhimit të fondit Pyjor dhe Kullosor	320,000	320,000
Shuma Bashkia Lushnje						**24,014,201**	**24,014,201**

Kërkohet miratimi i Këshillit Bashkiak për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar sipas tabelës.
Ju faleminderit!

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave
Juljana Hasalla

Për Drejtorinë e Financë–Buxhetit
Ervisa Çuko

Për Ndërmarjen e Pasurisë Publike
Elson Zeka

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 5147/1 Prot

Lushnje, më 14.01.2026

PROJEKT VENDIM

Nr 12 Datë 14 .01.2026

MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026 NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA, MIRATUAR ME VKB NR.122 DATË.23.12.2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____.01.2026, pasi analizoi relacionin e paraqitur "Mbi një shtesë në buxhetin e vitit 2026 miratuar me VKB nr.122 datë.23.12.2025", si dhe në Zbatim të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqëverisjen vendore, neni 54/dh, Ligjit nr.68/ 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 23 paragrafi 'Transferta e pakushtëzuar", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" me ndryshime, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për proçedurat Standarte të zbatimit të buxhetit", dhe ligjit nr Ligjin Nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", shkresës së dërguar nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore me nr.18059/15, datë 24.12.2025 si dhe aktit normative nr 19.12.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar"

PROPOZOJMË:

1.Të miratojë shtesën e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e vitit 2026 me 24,014,201 lekë sipas tabelës:

Institucioni	Programi	Gr	Kap.	Produkti	Pershkrimi I produktit	Vlera	Artikulli 602
2129010	AB129	00	01	V452AAB	Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur	22,361,731	22,361,731
2129010	AB129	00	01	V424AAB	Mirëmbajtja rutinë e kanaleve ujitëse dhe kanale kulluese	1,332,470	1,332,470
2129010	AB129	00	01	V426AAA	Shërbimi i Stafit të menaxhimit të fondit Pyjor dhe Kullosor	320,000	320,000
Shuma Bashkia Lushnje						**24,014,201**	**24,014,201**

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit, Ndërmarja e Pasurise Publike

3. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave
Juljana Hasalla

Për Drejtorinë e Financë–Buxhetit
Ervisa Çuko

Për Drejtorinë Juridike
Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Adresa : Lagja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 22139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com